



Pranuar / Dorezuar Prilbjen / Prodato Received / Delivery	06-04-2021	1	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHMBAK	1625	2021	113

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Anr. 115/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga Eshref Shabani, kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca, anëtarë, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr. 115/2021 të datës 02.03.2021, së ankuesit me adresë banimi fsh. Stanovc i Epërm, nga Komuna e Vushtrrisë sipas Aktgjykimit A. A. Nr.2589, të datës 28.01.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, kundër organit të punësimit Komuna e Vushtrrisë, në çështjen juridik „Ndërprenje e marrëdhënies së punës“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 05.04.2021, mori këtë;

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** ankesa Anr.115/2021, e ankuesit sipas Aktgjykimit Anr.2589, të datës 28.01.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative.
- II. MBETET NË FUQI**, Vendimi i datës 17.07.2018, me numër 34828/18, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, i Komunës së Vushtrrisë.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.10.2018, me Nr. A. 547/2018, ka nxjerr vendim me të cilin ka hedhur poshtë ankesën e ankuesit

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e datës 05.10.2018, me numër Nr. A. 547/2018, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.10.2018, ka parashtruar padinë konfliktive Administrative pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamentit për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/ Departamentit për Çështje Administrative, me datë 28.01.2021, An.2589/18, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesën padinë e paditësit duke shfuqizuar vendimin e datës 05.10.2018, A. Nr. 547/2018, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 115/2021, sipas, sipas Aktgjykim A. A. Nr. 2589/2018, të datës 28.01.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative; Aktvendimi i datës 21.02.2021, Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative; Padia e datës 29.11.2018, drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative; Vendimi i datës 05.10.2018, A. Nr.547/2018, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shënimin Civil të Kosovës; Ankesa e datës 27.08.2018, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shënimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 17.07.2018, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi i datës 21.05.2018, i Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit; Flete kthesa e datës 19.07.2018; Ankesa e datës 16.07.2018, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi i datës 13.05.2014, i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë; Akt Emërimi i datës 20.06.2014; Përgjigje në ankesë e datës 14.09.2018, me numër protokoli 5318/2018.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka analizuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështja Administrativ, A. Nr. 2589/18 të datës 28.01.2021, me të cilin ka aprovuar kërkesës padinë e paditësit si të bazuar në ligj, duke anuluar vendimin e datës 05.10.2018, A. nr. 547/2018, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Vushtrrisë, me datë 21.05.2018, me numër protokoli 393/2018, ka nxjerr vendim me të cilin ankuesi nga pozita „Drejtor i SHFMU”, Migjeni, në Stanovc, e ka sistemuar në pozitën Mësimdhënës i Biologjisë, në SHFMU”, në Stanovc i Poshtëm, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Drejtori i Drejtorisë ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuq.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Vushtrrisë, ka vepruar në pajtim me nenin 9, të Udhëzimit Administrativ 8/2014, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit në Institucionet Edukativo - Arsimore dhe Aftësues, ku thuhet se; **kandidateve të cilëve u ka përfunduar ose u është ndërprerë mandati i drejtorit/ zëvendës drejtorit në institucionin edukativo arsimore, të cilët në këto mandate kanë ardhur nga institucionet arsimore, u ruhet vendi i punës në këto institucione**, sepse nga shkresat e lendes del se ankuesi ka qenë i punësuar me Akt Emërimin e datës 20.06.2014, në pozitën „Drejtor i SHFMU, në fsh Stanovc i Epërm, dhe se afati i mbarimit ka qenë me 12.05.2018, prandaj kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, në Komunën e Vushtrrisë, ne rastin e sistemimit të ankuesit, Mësimdhënës i Biologjisë, në SHFMU” në Stanovc i Poshtëm, pas skadimit të mandatit të Drejtorit, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.



Kolegji si rrethanë vendimtare për refuzimin e ankesës ka marr faktin se ankuesit i ka skaduar mandati i drejtorit të shkollës, prandaj Drejtoria e Arsimit në Komunën e Vushtrrisë ka vepruar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Vushtrrisë, me rastin e nxjerrjes së Vendimi 34823/18 të datës 17.07.2018, ka vepruar në pajtim me dispozitat e të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me ankesën e ankueses

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda Nr. A. Nr. 115/2021



Rushitë KAJTAZI
Procesmbajtës

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Përfaqësuesit Juridik avokatit Skender Musa;
- Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë;
- Gjyqtarës Arjeta Sadiku;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Vushtrrisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së

